

Planifikimet buxhetore të komunave për vitin 2025



Korrik 2024



Co-funded by
the European Union



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra



Sweden
Sverige

Swiss Agency for Development
and Cooperation SDC

Planifikimet buxhetore të komunave për vitin 2025

Korrik 2024

— Përmbajtja

| | |
|--|----|
| Përmbledhje ekzekutive | 3 |
| 1. Hyrje | 4 |
| 2. Buxheti 2025: të hyrat dhe shpenzimet e komunave | 5 |
| 2.1 Zhvillimi ekonomik lokal | 5 |
| 2.2 Të hyrat vetanake | 7 |
| 2.3 Planifikimi i shpenzimeve për vitin 2025 | 8 |
| 2.4 Kategoria e subvencioneve në 15 komunat e Kosovës | 12 |
| 3. Dëgjimet buxhetore të komunave për Kornizën Afatmesme Buxhetore 2025–2027 | 13 |
| 4. Buxhetime i përgjegjshëm gjinor në buxhetin 2025 | 17 |
| Përfundim | 19 |
| Aneks 1 | 20 |

Deklaratë mohimi:

Ky publikim është bashkëfinancuar nga Bashkimi Evropian, Zvicra dhe Suedia përmes projektit DEMOS, zbatuar nga Helvetas Swiss Intercooperation. Përmbajtja e tij është përgjegjësi e vetme e Institutit GAP dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e Bashkimit Evropian, Zvicrës dhe Suedisë.

©DEMOS Publikuar: Korrik 2024, Prishtinë, Kosovë

Përmbledhje ekzekutive

Buxheti vjetor komunal është një nga instrumentet kryesore për financimin e projekteve infrastrukturore dhe promovimin e zhvillimit ekonomik në nivel lokal. Ajo siguron ofrimin e shërbimeve efektive dhe cilësore për qytetarë dhe një menaxhim efektiv i buxhetit siguron planifikim të përgjegjshëm financiar dhe shpërndarje të barabartë të burimeve për rritjen dhe zhvillimin e përgjithshëm të komunave. Planifikimi i qartë mbështet zhvillimin afatgjatë, duke ndihmuar komunat të plotësojnë nevojat e ardhshme. Për më tepër, buxhetet e detajuara ofrojnë llogaridhënie dhe transparencë, duke lejuar qytetarët të shohin se si shpenzohen paratë e tyre, duke nxitur besimin në qeverinë lokale. Përmes investimeve, subvencioneve dhe punësimit, komunat mund të ndikojnë në barazinë shoqërore. Planifikimet për buxhetin e vitit 2025 nga 15 komunat e përfshira në këtë analizë tregojnë një rritje prej 2–11% të buxheteve vjetore. Por, komunat vazhdojnë të mos kenë ndërlidhje të qartë mes prioriteteve afatmesme dhe buxhetit vjetor dhe shumica nuk kanë analizuar rreziqet buxhetore për vitin 2025, përfshirë detyrimet kontingjente të trashëguara dhe ato që mund të lindin nga vendimet gjyqësore.

Pjesa më e madhe e komunave që janë pjesë e këtij raporti shpenzojnë gjysmën e buxhetit të tyre (rreth 50%) në paga dhe mëditje, ku shpenzimet më të mëdha për këtë kategori vërehen te Komuna e Junikut dhe ajo e Kamenicës, përkatësisht me 66% dhe 59%. Në anën tjetër, investimet kapitale paraqesin kategorinë e dytë më të rëndësishme për shumicën e komunave. Të gjitha 15 komunat e analizuar në këtë raport kanë planifikuar të realizojnë 670 projekte kapitale, për të cilat do të ndahet buxhet prej 88 milionë euro. Nga to, vetëm 17 milionë (19.3%) do të shkojnë në projekte të reja, ndërsa 71 milionë euro (80.7%) do të përdoren për projekte që janë vazhdimësi nga viti 2024. Pozitive është se shumica e projekteve janë planifikuar jashtë qendrave të qyteteve, duke përfshirë edhe lokalitete të banuara me minoritete. Sa i përket planifikimeve për subvencione, Rahoveci dhe Podujeva do të shpenzojnë pjesën më të madhe në bujqësi (44% dhe 41%), ndërkaq Dragashi në kulturë, rini dhe sport (35%). Kurse, tek Prizreni dhe Vitia buxheti për subvencione është alokuar tek zyret e kryetarëve të komunave, i cili më pas shpërndahet varësisht nga nevojat dhe orientimet që i vendosin kryetarët e komunave.

Përveç Graçanicës, 14 komunat tjera kanë realizuar dëgjime buxhetore rreth Kornizës Afatmesme Buxhetore (KAB). Në përgjithësi, numri i qytetarëve në këto dëgjime mbetet ende shumë i ulët. Disa komuna, si Suhareka, kanë organizuar më shumë dëgjime buxhetore me qytetarët dhe kanë prezantuar më shumë detaje në procesverbale. Komuna të tjera, ndonëse të mëdha për nga numri i popullsisë, si Peja dhe Prizreni, kanë mbajtur më pak dëgjime buxhetore. Gjetjet e këtij raporti, nga analizimi i dëgjimeve buxhetore dhe KAB të miratuara, tregojnë një hap pozitiv të komunave në buxhetim, duke i trajtuar disa nga kërkesat e qytetarëve gjatë dëgjimeve buxhetore. Megjithatë një numër i madh i këtyre kërkesave mbetet jashtë draftit të buxhetit dhe në asnjë rast nuk haset ndonjë shpjegim apo arsye nga komunat se pse këto kërkesa nuk merren parasysh. Në 12 nga 15 komunat e analizuar, një numër i kërkesave të qytetarëve është përfshirë në KAB 2025-2027 të miratuar. Konkretisht, Komuna e Podujevës i ka përfshirë në KAB 15.3% të kërkesave të qytetarëve (11 nga gjithsej 72 propozime), ajo e Suharekës 13% (24 nga gjithsej 180 propozime), e Prizrenit 9% (9 nga gjithsej 95 propozime), etj. Ndërkaq, hendeku gjinor i përfaqësimit në këto konsultime ende mbetet i lartë, ku shumica e pjesëmarrësve ishin burra.

Mënyra e shpenzimit të buxhetit dhe politikat e ndërmarra mund të promovojnë barazinë gjinore apo të përforcojnë pabarazitë ekzistuese. Në rastin e planifikimit fillestar të buxhetit 2025, vetëm gjashtë nga 15 komunat që janë pjesë e analizës, duke përfshirë këtu Prizrenin, Podujevën, Rahovecin, Vitinë, Obiliqin dhe Graçanicën, kanë të përfshirë pjesën për Buxhetim të Përgjegjshëm Gjinor në KAB 2025–2027 me të dhëna bazike rreth numrit të punëtorëve në komuna apo numrit të përfituesve të subvencioneve.

1. Hyrje

Korniza Afatmesme Buxhetore (KAB) është dokumenti fillestar që përgatitet nga secila komunë në ciklin e përvitshëm buxhetor dhe i cili duhet të miratohet nga kuvendi komunal deri më 30 qershor të secilit vit.¹ Buxheti i komunës është dokumenti dhe instrumenti bazë përmes të cilit, komuna parasheh realizimin e planeve të saj. Përmes buxhetit, komuna tregon dhe reflekton mbështetjen për sektorët kyç si dhe demonstroi orientimin e saj se çfarë mbështetje do t'u japë çështjeve që mund t'i takojnë fushave infrastrukturore, shëndetësore, arsimore, rinore, bujqësore, çështjeve sociale, ambientale apo edhe të ngritjes së kapaciteteve të burimeve njerëzore. Për më shumë, i ndërtuar sipas kufijve buxhetorë të vënë për të hyrat e komunave nga grantet qeveritare dhe ato vetanake në qarkoren e parë² buxhetore të lëshuar nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve (MFPT) deri më 15 maj³ të secilit vit, dhe e cila është në harmoni me Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve (KASH) të miratuar deri më 30 prill⁴ të secilit vit nga Qeveria e Kosovës⁵, KAB përmban në të shumtën e rasteve edhe planifikimet e komunës edhe për investimet kapitale që do të bëhen në vitin vijues. KAB shërben edhe si dokument fillestar për ndërtimin e projektbuxhetit vjetor, ku ky i fundit duhet të dorëzohet në kuvendin komunal deri më 1 shtator. Deri në këtë periudhë, nëse ka nevojë, MFPT mund të lëshojë edhe qarkore tjera buxhetore⁶, të cilat duhet të merren parasysh gjatë përgatitjes së projektbuxhetit vjetor komunal. Pastaj, pas shqyrtimeve nga kuvendi komunal gjatë muajit shtator, i njëjti duhet të miratohet deri më 30 shtator. Në rast se dokumenti i buxhetit të miratuar në kuvendin komunal është hartuar sipas kritereve të paraqitura edhe në qarkoren(t) buxhetore, i njëjti nuk mund të pësojë ndryshime nga Qeveria dhe Ministri/ja i MFPT.⁷

Në kuadër të hartimit të KAB, komunat mbajnë konsultime publike, ku përmes dëgjimeve buxhetore dhe konsultimeve me shkrim dhe elektronike pranohen sugjerimet dhe kërkesat e qytetarëve. Bazuar në Udhëzimin Administrativ të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL) për administratë të hapur në komuna, pas hartimit të KAB, komunat janë të obliguara të organizojnë konsultime publike rreth saj, përfshirë këtu si mjet konsultimi, organizimin e dëgjimeve buxhetore.⁸ Pastaj, në fazën e përgatitjes së projektbuxhetit, komuna dhe kuvendi komunal obligohen gjithashtu të mbajnë dëgjime buxhetore me qytetarë, kjo bazuar në Ligjin për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë, si dhe në disa raste edhe si kërkesë nga qarkorja(et) buxhetore.

1 Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve. [Qarkorja buxhetore 2025/1](#). Qasur më 3 korrik 2024.

2 Duhet theksuar se llogaritja e nivelit të granteve qeveritare të prezantuar në qarkorën e parë 2025/1 është bërë duke përdorur të dhënat e regjistrimit të popullsisë së vitit 2011. Në ndërkohë në Kosovë është kryer edhe regjistrimi i popullsisë gjatë vitit 2024, dhe nuk dihet nëse do të ndodhë edhe azhurnimi i kufijëve më lartë nga MFPT edhe për buxhetit e vitit 2025 ose jo. Në kohën e përgatitjes së kësaj analize nuk ka pasur ndryshime të tilla.

3 Gazeta Zyrtare. [Ligji nr. 03/l-221 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 03/l-048 për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë](#). Neni 6.

4 Po aty, neni 19.

5 Nënkupton qeverinë qendrore.

6 Zakonisht qarkoret e dyta buxhetore lëshohen për të marrë të dhëna më të përditësuara për ndonjë kategori, sikurse numrit e saktë të të punësuarve nëpër komuna, për të reflektuar ndryshime pas inputeve të marrura nga KAB të miratuara, forumet e organizuara me autoritetet komunale, etj.

7 [Ligji nr. 03/l-048 për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë](#). Neni 20.5.

8 Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal. [Udhëzim administrativ \(MAPL\) nr.04/2023 për administratë të hapur në komuna](#). Neni 17 dhe 22.

Në këtë raport, Instituti GAP analizon zhvillimet kryesore në lidhje me planifikimin buxhetor të 15 komunave të Kosovës për vitin 2025, duke analizuar KAB 2025-2027 të miratuar, duke përfshirë këtu analizimin e shpërndarjes së investimeve kapitale nëpër lokalitete, se sa përfshihen grupet e marginalizuara në buxhet, siç janë gratë dhe minoritetet, si dhe se sa janë gjithëpërfshirëse komunat gjatë përgatitjes së buxhetit, duke organizuar konsultime publike. Komunat e analizuar në këtë raport janë Drenasi, Kaçaniku, Peja, Kamenica, Obiliqi, Graçanica, Suhareka, Rahoveci, Klina, Vitia, Dragashi, Juniku, Ferizaji, Podujeva dhe Prizreni. Këto komuna janë njëherit edhe përfituese të mbështetjes shtesë në aktivitete të ndryshme nga Helvetas (Demos) gjatë vitit 2025. Po ashtu, përzgjedhja e këtyre komunave është bërë për shkak të bashkëpunimit mes DEMOS dhe komunave lidhur me 'kontratën sociale';⁹ madhësisë së komunave sipas dimensionit demografik dhe atij gjeografik; si dhe sipas numrit të vendbanimeve në të cilat jeton një numër ose përqindje e konsiderueshme e komunitetit jo shumicë.


2. Buxheti 2025: të hyrat dhe shpenzimet e komunave

Buxheti i komunave vjen nga tri burime: nga grantet qeveritare (granti i përgjithshëm, granti për arsim dhe granti për shëndetësi), nga të hyrat vetanake dhe nga të hyrat e tjera. Grantet qeveritare ofrohen mbi baza vjetore për arsim, shëndetësi dhe nisur nga numri i banorëve dhe madhësia gjeografike e secilës komunë. Të hyrat vetanake, komunat i grumbullojnë nga realizimi i aktiviteteve të tyre, bazuar në kompetencat komunale dhe sipas rregulloreve komunale për taksa, gjoba dhe tarifa. Ndërsa të hyrat e tjera nuk janë të përvitshme, ato mund të vijnë nga projekte që mbështeten nga ministritë, agjencitë qeveritare, ndërmarrjet publike apo donatorët ndërkombëtarë.

2.1 Zhvillimi ekonomik lokal

Me rritjen ekonomike në vend dhe të hyrave buxhetore, çdo vit rritet edhe buxheti vjetor i komunave. Ky ndryshim buxhetor i komunave mund të reflektojë në prioritetet dhe strategjitë e zhvillimit të secilës komunë. Analiza e buxhetit të planifikuar të 15 komunave për vitin 2025 tregon një trend rritjeje në buxhetin e secilës komunë. Për vitin 2025, Komuna e Ferizajt ka rritjen më të lartë në buxhet me rreth 11.7%, pasuar nga Graçanica me rreth 10.8% dhe Klina me rreth 10.4%. Ndërsa, shkallën më të ulët të rritjes së buxhetit e ka Komuna e Obiliqit me një rritje vjetore prej 1.88%.

⁹ Kontrata sociale është marrëveshje mes komunës dhe një komuniteti apo lokaliteti për t'iu përmbajtur nevojave të atij komuniteti të shfaqura gjatë konsultimeve publike. Komuna zotimin e saj e përfshin në buxhet dhe në dokumente të tjera me rëndësi që pastaj mund të monitorohet ecuria e zbatimit të atij zotimi.

Figura 1. Buxheti i planifikuar i komunave dhe ndryshimi vjetor i tij

Burimi: Kornizat Afatmesme Buxhetore 2025–2027 të komunave të përfshira

Në dokumentin e miratuar të KAB 2025–2027, komunat në përgjithësi kanë paraqitur prioritetet e tyre afatmesme, mirëpo, në të shumtën e rasteve ato janë të numërta dhe që tejkalojnë ndjeshëm mundësitë e një buxheti vjetor komunal, dhe si rrjedhojë, është e vështirë të kuptohet një ndërlidhje e buxhetit vjetor me prioritetet specifike afatmesme. Një dukuri e tillë, vërehet ende edhe të projektbuxheti vjetor i qeverisë qendrore.¹⁰ Gjithashtu, shumica e komunave nuk kanë analizuar rreziqet nga aspekti buxhetor gjatë vitit 2025, se si ato mund të ndikojnë në zbatimin e planit të punës së tyre, sikurse nga detyrimet kontingjente të trashëguara, por edhe ato që mund të rrjedhin gjatë vitit për shkak të vendimeve të gjykatave. Kjo gjendje mund të ketë disa implikime. Së pari, pa ndërlidhjen e buxhetit me planet dhe strategjitë afatmesme dhe afatgjata të komunës apo edhe të vendit, rezikohet mos arritja e objektivave të synuara të këtyre strategjive. Këto dokument mund të përfshijnë Strategjitë e zhvillimit ekonomik lokal apo Planet lokale për veprim në mjedis apo edhe Strategjitë për integrimin e komuniteteve. Së dyti, mos marrja parasysh e detyrimeve kontingjente, jo vetëm të trashëguara, por edhe ato që mund të rrjedhin gjatë vitit, për shkak të vendimeve të gjykatave, mund të krijojnë barrë financiare të papritur për komunat. Këto detyrime mund të shtyjnë komunat të shkurtojnë buxhetet për projekte të rëndësishme ose pamundësojnë nisjen ose finalizimin e projekteve të caktuara. Së treti, kjo tregon edhe mungesë të menaxhimit efikas të burimeve financiare që pastaj mund të ndikojë në opinionin e auditimit, opinion ky që zakonisht reflekton në performancën ose imazhin e mirë ose jo të komunës.


10 Instituti GAP. [Nevoja për themelimin e një Institucioni të Pavarur Fiskal në Kosovë](#)

Për të përmbushur objektivat e tyre në vitin 2025, komunat do të shfrytëzojnë të hyrat nga transferet e përvitshme nga qeveria qendrore, taksat lokale, si dhe kontribute nga projekte dhe grante të ndryshme. Siç mund të shihet në figurën 2, Granti i përgjithshëm¹¹ përbën një pjesë të madhe të të hyrave, me përqindje që variojnë nga 26% në Obiliq deri në mbi 50% të buxhetit, përkatësisht 55% në Dragash. Gjithashtu, Granti për arsim¹² dhe Granti për shëndetësi¹³ kontribuojnë në mënyrë të konsiderueshme në të hyrat e komunave, me përqindje që shkojnë nga 19% në Graçanicë deri në 39% në Podujevë për arsimin, dhe nga 9% në Obiliq deri në 18% në Graçanicë për shëndetësinë. Dallimi kryesor mes të hyrave të komunave mbetet kryesisht te pjesëmarrja që kanë të hyrat vetanake në buxhetin vjetor. Disa nga komunat vazhdojnë të mos kenë progres për të rritur bazën e të hyrave vetanake, ku pjesëmarrja e kësaj kategorie në buxhetin vjetor në disa raste është vetëm 4%, sikurse të Dragashi. Ndërkaq, te disa komuna tjera, pjesëmarrja e kësaj kategorie shkon deri në 24%, sikurse në Graçanicë.

2.2 Të hyrat vetanake

Tek forma e paraqitjes së burimeve të të hyrave, në KAB 2025–2027, për dallim prej komunave të tjera, Komuna e Rahovecit dhe ajo e Junikut nuk i kanë ndarë grantet sipas kategorive, por i kanë paraqitur ato në një kategori të vetme. Mënyra e paraqitjes së granteve nga Komuna e Rahovecit dhe ajo e Junikut nuk është e duhur dhe shpërfill edhe sugjerimet e Ministrisë së Financave të dhëna në qarkoren e parë buxhetore të lëshuara për komuna.¹⁴ Në këto qarkore precizohet buxheti i secilës komunë nisur nga grantet dhe po ashtu u kërkohet komunave që gjatë hartimit të buxhetit t'i ndjekin rregullat që ofrojnë qartësi të plotë për palët e treta.

Figura 2. Burimet e financimit të komunave për vitin 2025



Burimi: Kornizat Afatmesme Buxhetore 2025–2027 të komunave të përfshira

11 Sipas [Ligjit për financat e pushtetit lokal](#) (LFPL), nenit 24, 10% të të hyrave totale të Qeverisë qendrore ndahen për komunat sipas formulave të përcaktuara në ligj.


12 Po aty. Bazuar në sistem të hapur të financimit, duke përdorur kriteret e Ministrisë së Shkencës, Teknologjisë dhe Arsimit në formulën e arsimit parauniversitar.

13 Po aty. Bazuar në sistem të hapur të financimit, duke përdorur kriteret e Ministrisë së Shëndetësisë në formulën e shëndetësisë primare.

14 Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve. [Qarkorja buxhetore për nivelin lokal](#). Fq 16.

Të hyrat vetanake janë burime financiare që komunat i mbledhin nga burimet e brendshme, të cilat përfshijnë taksat lokale, tarifat për shërbime dhe të ardhurat nga pronat komunale. Këto të hyra janë të rëndësishme sepse ofrojnë një nivel të caktuar të pavarësisë financiare për komunat, duke u mundësuar atyre të marrin vendime autonome për investimet dhe shpenzimet publike. Për dallim prej të hyrave të tjera si granti i përgjithshëm dhe ato specifike, të cilat shpesh janë të destinuara për përdorime të caktuara dhe kanë kushte të vendosura nga niveli qendror, të hyrat vetanake mund të përdoren në mënyrë më fleksibile për të përmbushur nevojat specifike të komunitetit lokal, brenda kompetencave komunale, përjashtuar kategorinë e pagave. Komunat me rritjen më të madhe të planifikuar të të hyrave vetanake gjatë vitit 2025 janë Juniku me 49%, Ferizaji me 47.4%, Vitia me 34.4% dhe Rahoveci me 27.8%. Ndërsa, komunat me rritjen më të ulët të të hyrave vetanake për vitin në fjalë janë Graçanica me 2.2%, Kaçaniku me 2.8% dhe Obiliqi me 2.9%.

Figura 3. Të hyrat vetanake të komunave dhe ndryshimi vjetor i tyre



Burimi: Kornizat Afatmesme Buxhetore 2025–2027 të komunave të përfshira


2.3 Planifikimi i shpenzimeve për vitin 2025

Komunat shpenzojnë buxhetin e tyre për të përmbushur nevojat e ndryshme të komunitetit dhe për të mbështetur zhvillimin lokal. Këto shpenzime përfshijnë subvencionet dhe transferet për të ndihmuar sektorë të veçantë, pagat dhe mëditjet për punonjësit komunalë, mallrat dhe shërbimet e nevojshme për funksionimin e përditshëm të komunës, investimet kapitale për zhvillimin e projekteve të mëdha infrastrukturore, si dhe shpenzimet komunale për të mbuluar kostot operative. Shpenzimet variojnë nga komuna në komunë, bazuar edhe në prioritetet dhe nevojat specifike të tyre.

Kategoria e pagave dhe mëditjeve zë përqindjen më të lartë të buxhetit në shumicën e komunave. Pjesa më e madhe e komunave shpenzojnë më shumë se gjysmën e buxhetit të tyre në paga dhe mëditje, ku shpenzimet më të mëdha për këtë kategori vërehen te Komuna e Junikut dhe ajo e Kamenicës, përkatësisht me 66% dhe 59%, respektivisht. Në anën tjetër, investimet kapitale paraqesin kategorinë e dytë më të rëndësishme për shumicën e komunave, me përqindje që variojnë nga 40% te Komuna e Obiliqit (njëherit edhe kategoria më e rëndësishme për këtë komunë) apo 17% te Komuna e Kamenicës.

Komunat me shpenzimet më të mëdha në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve dalin të jenë ajo e Ferizajit me 22% të buxhetit, pasuar nga Komuna e Graçanicës dhe e Prizrenit me nga 20%. Ndërsa, kategoria e subvencioneve dhe transfereve, si dhe ajo e shpenzimeve komunale zënë një përqindje të vogël të buxhetit të të gjitha komunat.

Figura 4. Kategoritë e shpenzimeve të komunave për vitin 2025



Burimi: Kornizat Afatmesme Buxhetore 2025–2027 të komunave të përfshira

Edhe investimet publike nga komunat kanë shënuar rritje nga viti në vit, por, problemet që i veçojnë këto investime mbesin të njëjta dhe përsëriten në vazhdimësi. Në këtë drejtim, një nga problemet më të mëdha është pamundësia e komunave për t'i realizuar investimet brenda kohës së paraparë dhe kështu barten nga viti në vit. Nga vlerësimet e Zyrës Kombëtare të Auditimit, arsyet pse barten projektet nga viti në vit në nivelin lokal përfshijnë mosplanifikimin e duhur të projektit investues, mos-zotimin e plotë të mjeteve financiare në buxhet për projektin investues, kontestet pronësore në terren dhe mungesën e kapaciteteve teknike dhe profesionale të kompanive private për kryerjen e punëve publike.¹⁵

Nga 15 komunat e analizuar në këtë raport, gjatë fazës së parë të planifikimit buxhetor për vitin e ardhshëm 2025 janë paraparë 670 projekte kapitale. Prej tyre, 500 projekte do të barten nga viti 2024, ndërsa 170 projekte janë planifikuar nga këto komuna si projekte të reja. Paraqitur në përqindje, vetëm 25% e projekteve të parapara nga 15 komuna do të jenë të reja, ndërsa 75% e tyre do të barten.

¹⁵ Zyra Kombëtare e Auditimit. [Vlera për para në ndërtimin e rrugëve lokale dhe rajonale](#). Fq. 10 dhe fq. 21.

Katër komuna (Drenasi, Prizreni, Ferizaj dhe Obiliqi) nuk kanë paraparë asnjë projekt të ri për vitin 2025. Përqindje të lartë të bartjes së projekteve janë hasur edhe në Dragash, Graçanicë, Kamenicë dhe Podujevë. Komuna që më së paku do të bartë projekte kapitale për vitin e ardhshëm është Peja. Në këtë komunë, nga 89 projekte të parapara, vetëm 13 prej tyre janë projekte që barten.

Për 670 projekte që janë paraparë në fazën e parë të planifikimit të buxhetit për vitin 2025 nga këto 15 komuna, shuma e buxhetit të dedikuar është afro 88 milionë euro. Vetëm 17 milionë euro (19%) nga këto mjete do të shkojnë në projekte të reja, ndërsa 71 milionë euro (81%) do të mbesin në dispozicion të projekteve që barten nga viti 2024.

Tabela 1. Investimet e planifikuara kapitale për vitin 2025 në 15 komuna të Kosovës sipas KAB të miratuara në Kuvendet Komunale gjatë muajit qershor 2024

| Komunat | Numri i projekteve kapitale | Numri i projekteve të reja kapitale | Përqindja e projekteve të reja kapitale | Numri i projekteve që do barten nga viti 2024 | Përqindja e projekteve të bartura kapitale | Shuma financiare e projekteve të reja (Euro) | Shuma financiare e projekteve të bartura (Euro) | Sa nga këto projekte janë premtuar në fushatën zgjedhore |
|-----------|-----------------------------|-------------------------------------|---|---|--|--|---|--|
| Dragash | 57 | 22 | 39% | 35 | 61% | 1,407,673 | 2,908,630 | 5 |
| Drenas | 39 | 0 | 0% | 39 | 100% | | 6,225,103 | 4 |
| Ferizaj | 59 | 0 | 0% | 59 | 100% | | 4,925,951 | 6 |
| Graçanicë | 21 | 6 | 29% | 15 | 71% | 500,000 | 1,816,082 | |
| Junik | 38 | 12 | 32% | 26 | 68% | 1,340,000 | 3,616,326 | 6 |
| Kaçanik | 28 | 14 | 50% | 14 | 50% | 1,187,000 | 1,382,000 | 11 |
| Kamenicë | 17 | 2 | 12% | 15 | 88% | | 7,618,000 | 4 |
| Klinë | 29 | 4 | 14% | 25 | 86% | 1,020,000 | 2,063,653 | 7 |
| Obiliq | 25 | 0 | 0% | 25 | 100% | - | 5,157,826 | 7 |
| Pejë | 89 | 76 | 85% | 13 | 15% | 9,367,595 | 2,202,956 | 9 |
| Podujevë | 62 | 13 | 21% | 49 | 79% | 922,000 € | 6,573,530 | 12 |
| Prizren | 129 | 0 | 0% | 129 | 100% | - | 20,179,741 | 16 |
| Rahovec | 6 | 2 | 33% | 4 | 67% | - | 2,701,576 | 3 |
| Suharekë | 71 | 19 | 27% | 52 | 73% | 1,438,048 | 3,139,000 | 6 |
| Viti | / | / | / | / | / | / | / | / |

Komuna e Vitisë nuk i ka pasqyruar në KAB listën e projekteve kapitale.
Burimi: Kornizat Afatmesme Buxhetore 2025–2027 të komunave të përfshira, Letërnjoftimi i Komunave – GAP, Buxheti i Kosovës 2023 dhe programet elektorale të kryetarëve të komunave.

Nga të dhënat e analizuar, afro gjysma e lokaliteteve nuk do të përfitojnë nga buxheti i investimeve kapitale për vitin 2025. Kësisoj, 15 komunat e analizuar përbëjnë 565 lokalitete, ku 285 lokalitete janë përfshirë në projektet kapitale që janë planifikuar në fazën e parë për vitin 2025, ndërsa 280 lokalitete nuk përfshihen. Pozitive rezulton të jetë se një numër i konsiderueshëm i komunave, projektet me shumën më të lartë financiare i kanë paraparë jashtë zonës së qendrës së qytetit. Në raste, sikur në komunën e Pejës, projekti më i madh infrastrukturor në vitin 2025 është paraparë të realizohet në një lokalitet të populluar nga minoritetet. Projektet kapitale që janë paraparë të realizohen ose

të finalizohen në vitin e ardhshëm në pjesën më të madhe të rasteve nuk del të jenë premtuar nga kryetarët e komunave gjatë fushatës për zgjedhjet lokale të vitin 2021. Kështu nga 670 projekte të parapara në 15 komuna, vetëm 96 prej tyre apo 14.3% janë premtuar në fushatë.

Tabela 2. Numri i lokaliteteve që përfshihen në buxhetin për vitin 2025 për projektet kapitale, vlerësuar në 15 komuna

| Komunat | Numri i lokaliteteve | Numri i lokaliteteve që përfshihen në investime kapitale | Numri i lokaliteteve që nuk përfshihen në investime kapitale | Lokaliteti në të cilin parashihet projekti më i shtrenjtë kapital |
|-----------|----------------------|--|--|---|
| Dragash | 35 | 25 | 10 | Brezne |
| Drenas | 36 | 28 | 8 | Qendër |
| Ferizaj | 43 | 15 | 28 | Jezerc |
| Graçanicë | 15 | 12 | 3 | Qendër |
| Junik | 2 | 2 | 0 | Qendër |
| Kaçanik | 28 | 11 | 17 | Qendër |
| Kamenicë | 53 | 12 | 41 | Zhujë |
| Klinë | 42 | 15 | 27 | Dollc |
| Obiliq | 19 | 11 | 8 | Qendër |
| Pejë | 69 | 39 | 30 | Vitimiricë (e populluar me minoritete) |
| Podujevë | 77 | 42 | 35 | Qendër |
| Prizren | 74 | 42 | 32 | Qendër |
| Rahovec | 33 | 4 | 29 | Opterushë |
| Suharekë | 39 | 27 | 12 | Qendër |
| Viti | / | / | / | / |

Komuna e Vitisë nuk e ka pasqyruar në KAB listën e projekteve kapitale. Burimi: Kornizat Afatmesme Buxhetore 2025–2027 të komunave të përfshira

Ndonëse kategoria e subvencioneve dhe transfereve zë përqindje relativisht të vogël të buxhetit total të komunave, ato janë shumë të rëndësishme sepse ndihmojnë në mbështetjen financiare të projekteve dhe iniciativave që kontribuojnë në zhvillimin ekonomik dhe social të komuniteteve lokale. Nëpërmjet subvencioneve, komunat mund të përkrahin fusha të ndryshme si bujqësia, arsimi, kultura, sporti dhe shëndetësia, duke përmirësuar kështu cilësinë e jetës së qytetarëve.

Duke analizuar KAB të komunave, vërehet se komunat kanë prioritet të ndryshme në shpenzimet e tyre për subvencione. Te Komuna e Rahovecit dhe Komuna e Podujevës, një përqindje e konsiderueshme shpenzohet në bujqësi (44% dhe 41%, respektivisht). Ndërsa, Komuna e Dragashit i dedikon rreth 35% të subvencioneve në kulturë, rini dhe sport. Në rastin e Komunës së Prizrenit, shumica e subvencioneve janë të buxhetuara në zyrën e kryetarit (99%), ndërsa te Komuna e Vitisë, 93% e subvencioneve janë të buxhetuara tek administrata. Këto zyre apo drejtori pastaj bëjnë shpërndarjen e këtyre subvencioneve varësisht nga nevojat dhe orientimet që i vendosin kryetarët e komunave apo drejtorët e drejtorive.


Pra, komunat nuk prezantojnë një orientim të saktë se cilat janë fushat prioritare

të tyre kësisoj rrisin diskrecionin e komunës dhe kryetarëve në alokime, të cilat mund të jenë edhe ad-hoc. Një kategori tjetër e rëndësishme mbetet edhe arsimit dhe shkenca, ku Komuna e Obiliqit prin me 27% të buxhetit të subvencioneve të përqendruara për këtë kategori, pasuar nga Komuna e Drenasit, Ferizajit dhe Kamenicës.

Dy kategoritë me përqendrimin më të ulët të subvencioneve dhe transfereve janë ato të çështjeve gjinore dhe komuniteteve. Shpërndarjen e subvencioneve për kategorinë e çështjeve gjinore e ka të paraparë vetëm Komuna e Klinës dhe ajo e Kamenicës me 1% të totalit të përgjithshëm. Kurse, për Zyrën Komunale për Komunitete dhe Kthim, ndarje të subvencioneve ka paraparë vetëm Komuna e Kamenicës, me vlerë monetare prej 5 mijë euro, apo 1% të totalit të përgjithshëm. Kjo nënkupton mungesë prioritizimi ose vëmendjeje ndaj këtyre çështjeve nga ana e komunave. Po ashtu, mund të rezultojë në mosadresimin e nevojave specifike të këtyre kategorive, çka mund të përkeqësojë pabarazitë ekzistuese. Për çështjet gjinore, një përqindje kaq e vogël e subvencioneve mund të mos jetë e mjaftueshme për të mbështetur programe të rëndësishme për barazinë gjinore dhe adresimin e nevojave që dalin në këtë fushë.

2.4 Kategoria e subvencioneve në 15 komnatat e Kosovës

Figura 5. Ndarja e subvencioneve nga komnatat në vitin 2025




Burimi: Kornizat Afatmesme Buxhetore 2025–2027 të komunave të përfshira

Sa i përket shpenzimeve të përgjithshme për këto dy kategori, Komuna e Pejës ka përqindjen më të lartë të ndarjes së buxhetit për Zyrën Komunale për Komunitete dhe Kthim me 1.53% të shumës totale (pjesa më e madhe e tyre të ndara për

investime kapitale), pasuar nga Rahoveci me 0.68% dhe Kamenica me 0.37%.¹⁶ Ndërkohë, disa komuna si Obiliqi dhe Suhareka kanë ndarje shumë të ulët të buxhetit për këtë zyrë. Krahasuar sipas kategorive ekonomike, del se kategoria e pagave dhe mëditjeve shënon pjesën më të madhe, pasuar nga ajo e mallrave dhe shërbimeve. Këto zyra nuk kanë ndonjë rol të përcaktuar ligjor në hartimin e buxhetit. Ajo që ndodh në praktikë është se këto zyra kanë një koordinim të mirë me komitetet për komunitete në kuvendet komunale dhe pastaj këto komitete shtyjnë përpara kërkesat dhe nevojat e komuniteteve gjatë hartimit (diskutimit) të buxhetit. Kjo ngase komiteti për komunitete, krahas komitetit për politikë e financa, janë të vetmet komitete obligative në pushtetin lokal.

Figura 6. Buxheti total i komunave dhe pjesëmarrja e buxhetit të dedikuar për Zyrën Komunale për Komunitete dhe Kthim



Burimi: Kornizat Afatmesme Buxhetore 2025–2027 të komunave të përfshira

3. Dëgjimet buxhetore të komunave për Kornizën Afatmesme Buxhetore 2025–2027


Ndonëse baza aktuale ligjore nuk specifikon numrin e dëgjimeve buxhetore që duhet të organizohen rreth KAB, gjetjet tregojnë se edhe për KAB 2025–2027, disa nga komunat e përfshira në këtë analizë kanë realizuar dëgjime buxhetore të numërta. Bazuar në Udhëzimin Administrativ të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL) për administratë të hapur në komuna, në rastin e organizimit të dëgjimeve buxhetore, komuna obligohet të publikojë procesverbalet e atyre dëgjimeve.¹⁷ Nga 15 komunat e analizuara në këtë raport, përveç Graçanicës, të gjitha 14 komunat tjera kanë realizuar dëgjime buxhetore rreth KAB.

Qasja mes komunave dallon sa i përket realizimit të dëgjimeve buxhetore me qytetarë rreth KAB 2025–2027, ku disa nga to kanë realizuar një numër më të madh të dëgjimeve dhe kanë prezantuar më shumë detaje tjera rreth dëgjimeve, ndërkaq disa të tjera jo. Komunat si ajo e Shtimes, Suharekës dhe Klinës kanë mbajtur numër më të madh të dëgjimeve buxhetore, ndërkaq disa komuna që janë edhe më të mëdha për nga numri i popullsisë, sikurse ajo e Pejës dhe Prizrenit, kanë mbajtur më pak dëgjime buxhetore.

¹⁶ Në disa nga komunat nuk jetojnë fare komunitete sic tregon Figura 12 në Aneks.

¹⁷ MAPL. [Udhëzim administrativ \(MAPL\) nr.04/2023 për administratë të hapur në komuna](#). Neni 12.

Figura 7. Numri i dëgjimeve buxhetore nga komunat për KAB 2025–2027



Burimi: Procesverbalet e paraqitura nga komunat në faqen e tyre zyrtare lidhur me kërkesat e paraqitura gjatë konsultimeve buxhetore për KAB 2025 -2027

Në dëgjimet buxhetore të mbajtura nga komunat, dallon numri i pjesëmarrësve, ku në disa raste, si në komunën e Kamenicës, kishte një numër më të vogël të pjesëmarrësve, me vetëm pesë pjesëmarrës në një dëgjim buxhetor. Ndërsa, në raste tjera, si në atë të Pejës, ndonëse është mbajtur vetëm një dëgjim buxhetor, pjesëmarrës ishin 66 persona, apo në Drenas në dy dëgjime buxhetore ishin 106 pjesëmarrës. Në rastin e Kaçanikut dhe Obiliqit, në procesverbale nuk tregohet numri i pjesëmarrësve.

Numri më i madh i propozimeve dhe kërkesave të paraqitura nga qytetarët është në komunat që kanë organizuar më shumë dëgjime buxhetore, sikurse komuna e Shtimes me 186 propozime të pranuar, komuna e Suharekës me 180, etj. Ndërkaq, më pak propozime ka marrë Peja në dëgjimin buxhetor. Te rasti i Kamenicës, nuk evidendohet asnjë kërkesë e parashtruar. Në procesverbalet e paraqitura nga komunat nuk ofrohen sqarime ose komente në rastet kur propozimet e dhëna nga qytetarët janë refuzuar, kjo nënkupton që komunat vazhdojnë të ndjekin qasjen e refuzimit të kërkesave pa dhënë sqarime ose arsytetime se pse ka ardhur deri të refuzimi.

Tabela 3. Numri i dëgjimeve buxhetore, pjesëmarrësve dhe propozimeve nga qytetarët rreth KAB


| | Dragash | Drenas | Ferizaj | Junik | Kaçanik | Kamenicë | Klinë | Obiliq | Pejë | Prizren | Shtime | Skënderaj | Suharekë | Podujevë | Rahovec |
|--|---------|--------|---------|-------|---------|----------|-------|--------|------|---------|--------|-----------|----------|----------|---------|
| Numri i dëgjimeve buxhetore | 3 | 2 | 2 | 1 | 1 | 1 | 10 | 5 | 1 | 2 | 15 | 4 | 13 | 4 | 5 |
| Numri i pjesëmarrësve | 96 | 106 | 75 | 26 | / | 13 | 209 | / | 66 | 52 | 185 | 130 | 200 | 44 | 210 |
| Numri i propozimeve | 14 | 14 | 62 | 18 | 18 | 0 | 79 | 17 | 9 | 95 | 186 | 25 | 180 | 72 | 34 |
| Numri i kërkesave të pranuar nga komunat | 1 | 5 | 5 | 2 | 1 | / | 5 | 2 | 1 | 9 | / | / | 24 | 11 | / |

Burimi: Procesverbalet buxhetore të komunave për KAB 2025–2027

/ - Nuk ka të dhëna

Për komunat të cilat kanë prezantuar të dhëna të mjaftueshme nëpër procesverbale, në shumicën e takimeve për të cilat janë prezantuar të dhëna sipas gjinisë, pjesëmarrësit ishin burra, sikurse në Klinë (98%), Ferizaj (87%), Dragash (80%), Prizren (79%), etj. Ndërkaq, një pjesëmarrje pak më e lartë e grave në dëgjimet buxhetore vërehet në Skënderaj (65%), Rahovec (44%) dhe Pejë (36%).

Figura 8. Struktura gjinore e pjesëmarrësve në dëgjimet buxhetore sipas të dhënave të procesverbaleve




Burimi: Procesverbalet buxhetore të komunave rreth KAB 2025–2027

Përveç aspektit formal të organizimit të dëgjimeve buxhetore, thelbësore mbetet që propozimet e qytetarëve të merren parasysh nga qeveritë lokale dhe sipas hapësirës buxhetore, të inkuadrohen në projektbuxhetin e vitit

2025. Nisur nga kjo, Komuna e Vitisë, në KAB të miratuar nuk ka përfshirë fare listen e investimeve kapitale të parapara për vitin vijues, duke argumentuar se të njëjtat do të përfshihen në projektbuxhetin final, pasi të jenë konsideruar të gjitha propozimet e qytetarëve nga dëgjimet buxhetore gjatë hartimit të projektbuxhetit. Ndërkaq, nisur nga i njëjti argument, Komuna e Rahovecit ka përfshirë vetëm disa projekte, por duke mos u vënë kosto as atyre, kurse Komuna e Kamenicës i ka të paraqitura prioritetet investive në vija të trasha (krijimin e kushteve më të mira infrastrukturore, parqeve për fëmijë, hapësirave rekreative, etj).

Gjetjet e këtij raporti, nga analizimi i dëgjimeve buxhetore dhe KAB të miratuara, tregojnë një hap pozitiv të komunave në buxhetim, duke i trajtuar me seriozitet kërkesat e qytetarëve gjatë dëgjimeve buxhetore. Konkretisht, në 12 nga 15 komunitat e analizuar, siç tregon Figura 9, disa nga kërkesat e qytetarëve janë përfshirë në KAB 2025 të miratuar. Numri më i madh i kërkesave të pranuar të qytetarëve ishte nga Komuna e Podujevës (15.3%), Suharekës (13%), Prizrenit (9.4%), etj. Shumica e kërkesave të qytetarëve në dëgjime buxhetore ishin të natyrës së investimeve kapitale.

Figura 9. Numri i kërkesave të qytetarëve të përfshira në projektet e parapara për vitin 2025



Burimi: Procesverbalet buxhetore të komunave dhe KAB të miratuar 2025–2027

4. Buxhetimi i përgjegjshëm gjinor në buxhetin 2025

Buxhetimi i përgjegjshëm gjinor (BPGj) është një mjet i rëndësishëm që siguron që burimet publike të adresojnë nevojat e gjinive të ndryshme, duke promovuar barazinë dhe përfaqësimin e të gjithëve. BPGj rrit efektivitetin, shpërndarjen e burimeve, transparencën dhe llogaridhënien në buxhetet komunale. Ajo mbështet rritjen gjithëpërfshirëse, adreson pabarazitë sociale dhe inkurajon pjesëmarrjen duke marrë parasysh perspektivat e ndryshme gjinore. Në këtë aspekt, komunat duhet të marrin parasysh nevojat dhe prioritetet e burrave, grave, djemve e vajzave në shpenzimin e buxhetit të tyre. Nismat dhe politikat e ndërmarra mund të ndikojnë ose për të promovuar barazinë gjinore ose për të përforcuar pabarazitë ekzistuese. Sipas Ligjit për barazi gjinore në Kosovë, buxhetimi gjinor është obligim ligjor për të gjitha institucionet. Ndër të tjera, sipas Kornizës Plotësuese për Vlerësimin e Menaxhimit të Përgjegjshëm Gjinor të Financave Publike (PEFA GRPFM) të kryer për Kosovën, kjo nënkupton që të ketë analizë mbi ndikimin gjinor të politikave të propozuara buxhetore; investime publike që marrin për bazë ndikimin gjinor; përfshirje të buxhetimit të përgjegjshëm gjinor (BPGj) në qarkoret buxhetore; përfshirje të buxhetimit të përgjegjshëm gjinor në projektbuxhet; të dhëna të ndara sipas gjinisë për përfituesit e shërbimeve publike; mbajtje të shënimeve për shpenzimet buxhetore të ndara sipas gjinisë; raportim i cili bazohet në informata për ndikimin gjinor; vlerësim të ndikimit gjinor për shërbimet; dhe përfshirje të ndikimit gjinor në procesin e mbikëqyrjes legjislative. Por, sipas raportit të PEFA, në rastin e Kosovës asnjë nga këto kategoritë më lartë nuk përfshihet plotësisht.¹⁸ Kultura institucionale e cila përgjithësisht nuk e ka promovuar dhe nuk është bazuar në parimet gjinore dhe mungesa apo vonesa e aplikimit të procedurave ku kërkohet buxhetim gjinor, mund të jenë ndër arsyet e mospërfshirjes së kategorive më lartë.

Në kohën kur komunat fillojnë të përgatisin projektbuxhetin vjetor, bazuar nga qarkoret buxhetore të lëshuara nga MFPT, ato janë të obliguara¹⁹ të ofrojnë të dhëna edhe për buxhetimin e përgjegjshëm gjinor. Nisur nga ky rezultat kjo besohet që vjen edhe nga fakti që MFPT nuk e ka bërë këtë proces të detyrueshëm, ndonëse me Programin e Kosovës për Barazi Gjinore 2020–2024 i kërkohet MFPT që të bëjë këtë proces të detyrueshëm edhe përmes amandamentimit të Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë.²⁰ Të njëjtin rekomandim e kanë dhënë edhe gratë deputete në Kuvendin e Kosovës në nëntor të 2020. Por, buxhetimi i përgjegjshëm gjinor ende nuk është përfshirë në Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë.²¹


Disa prej komunave kanë paraqitur të dhëna për BPGj edhe në KAB, duke përfshirë të dhëna siç kërkohen nga qarkorja buxhetore për projektbuxhetin komunal, por jo edhe për detaje tjera siç mund të jetë ndikimi i politikave të ndryshme që planifikojnë komunat t'i ndërmarrin. Konkretisht, vetëm gjashtë nga 15 komunat që janë pjesë e analizës, duke përfshirë këtu Prizrenin, Podujevën, Rahovecin, Vitinë, Obiliqin dhe Graçanicën, kanë të përfshirë pjesën për BPGj në KAB 2025–2027. Numri i grave dhe burrave të punësuar në këto komuna në vitin 2025 do të jetë thuajse i njëjtë, ku në katër nga to, siç tregon figura më poshtë, numri më i madh i të punësuarëve në komunë është gra.

18 PEFA. [Public Expenditure and Financial Accountability \(PEFA\) Performance Assessment Report – Supplementary Framework for Assessing Gender Responsive Public Financial Management \(Annex VI\)](#).

19 [Ligji për Barazi Gjinore](#), Neni 5, paragrafi 1.5


20 Agjencia për Barazi Gjinore. [Programi i Kosovës për Barazi Gjinore 2020–2024](#), qershor 2020. Fq.23–24

21 Kuvendi i Kosovës – Grupi i Grave Deputete. [Analizë e ndikimit gjinor të Projektbuxhetit të Republikës së Kosovës për vitin 2021](#). Nëntor 2020.

Figura 10. Numri i punëtorëve të komunës sipas gjinisë, 2025

Burimi: Kornizat Aftatmesme Buxhetore 2025–2027 të komunave të përfshira

Por, edhe tek këto komuna, jo të gjitha kanë publikuar të dhëna për të gjithë sektorët. Vetëm komunat e Obiliqit, Podujevës dhe Vitisë, kanë prezantuar të dhëna edhe për planifikimet rreth ndarjeve së subvencioneve sipas gjinisë. Ndarje krejtësisht të barabartë parashihet të bëjë Komuna e Vitisë, ndërkaq numër më i madh i përfituesve burra planifikohet në Komunën e Obiliqit.

Figura 11. Përfituesit e subvencioneve sipas gjinisë, 2025

Burimi: Kornizat Aftatmesme Buxhetore 2025–2027 të komunave të përfshira

Përfundim

Analiza e buxhetit të planifikuar të komunave për vitin 2025 tregon një trend rritjeje në buxhetin e secilës komunë. Për vitin 2025, Komuna e Ferizajt ka rritjen më të lartë në buxhet, pasuar nga Graçanica dhe Klina. Ndërsa, shkallën më të ulët të rritjes së buxhetit e ka Komuna e Obiliqit. Por, në KAB të miratuara nuk mund të dallohet qartë një ndërlidhje e buxhetit vjetor me prioritetet specifike afatmesme. Gjithashtu, vetëm disa nga 15 komunat kanë analizuar rreziqet nga aspekti buxhetor gjatë vitit 2025, se si ato mund të ndikojnë në zbatimin e planit të punës së tyre, sikurse nga detyrimet kontingjente të trashëguara, por edhe ato që mund të rrjedhin gjatë vitit për shkak të vendimeve përmbarimore apo të instancave gjyqësore.

Në shumicën e komunave, kategoria e pagave dhe mëditjeve zë përqindjen më të lartë të buxhetit, pasuar nga investimet kapitale. Tek këto të fundit, nga 670 projekte kapitale gjithsej të parapara për t'u realizuar në vitin 2025, pjesa më e madhe (81%) janë investime të bartura nga viti 2024.

Në dëgjimet buxhetore të mbajtura nga komunat rreth KAB 2025–2027, dallon numri i pjesëmarrësve, por në përgjithësi ky numër mbetet tejet i vogël dhe hendeku gjinor i përfaqësimit në këto konsultime mbetet i lartë.

Komunat duhet të përqendrohen në rritjen e të hyrave vetanake për të siguruar pavarësi më të madhe financiare, e cila lejon pastaj hapësirë më të madhe për investime kapitale. Po ashtu, prioritetet afatmesme të komunave duhet të jenë më të qarta dhe të lidhura ngushtë me mundësitë buxhetore. Kësisoj, ato mund të priorizojnë investimet kapitale që kanë ndikim të madh në përmirësimin e infrastrukturës dhe cilësinë e jetës së qytetarëve, duke rritur në këtë formë mundësinë për të pasur një zhvillim ekonomik më të theksuar.

Komunat duhet të përmirësojnë buxhetimin gjinor duke përfshirë analiza të detajuara mbi ndikimin gjinor të politikave dhe investimeve publike. Përfshirja e buxhetimit gjinor në të gjitha fazat e procesit buxhetor, duke filluar nga hartimi i KAB, konsultimet publike dhe deri në draftin final të buxhetit. Kjo besohet që do të ndikonte në përmirësimin e gjendjes jo të mirë të buxhetimit gjinor në vend. Po ashtu, rritja e transparencës në procesin buxhetor dhe përfshirja e qytetarëve në konsultime është thelbësore. Komunat duhet të organizojnë më shumë dëgjime buxhetore dhe të marrin parasysh sugjerimet e qytetarëve në mënyrë efektive.

Aneks 1

Tabela 4. Disa nga kërkesat e qytetarëve nga dëgjimet buxhetore të përfshira në buxhetin e vitit 2025

| Komuna | Dëgjimet buxhetore | Projektet e parapara për 2025 në KAB të miratuar |
|---------|--|--|
| Dragash | Zona 1 km nga Plavë deri te Viva Fresh të ketë trotuare dhe infrastrukturë më të mirë. | Kubëzimi i rrugëve në fshatin Plavë dhe ndriçimi publik. |
| Drenas | Pastrimi i mbeturinave, përfundimi i shtrirjes së rrjetit të kanalizimeve dhe përfundimi i rrugeve dhe trotuareve në Korroticë të Epërme | Asfaltimi i rrugës në fshatin Zabel i Ulët dhe i Epërm, Korretic e Ulët dhe Epërme. |
| | Rrethimi i varrezave, ndërtimi i trotuareve dhe infrastrukturës së ujërave të zeza në Komoran I&II | Zgjerimi dhe riparimi i trotuarëve dhe parkingjeve në Drenas dhe Komoran. |
| | | Rregullimi dhe rrethimi i varrezave në Komunën e Drenasit dhe Komoran. |
| | Gjithashtu ndriçimin publik, ujësjellësin dhe ndërtimin e rrugëve. (Fshatrat Poklek i Vjetër, Poklek i Ri, Vasilevë) | Asfaltimi i rrugës në fshatin Poklek i Vjetër, Poklek i Ri, Vasilevë. |
| | Kërkesa për rrugën kryesore Arllat-Negroc. | Asfaltimi i rrugës në fshatin Arllat, Negroc, Gjergjicë, si dhe Bytyq. |
| Junik | Kanalizimi i ujërave të zeza në lagjen Krasniqi, rruga Shafrane | Rrregullimi i rrjetit të ujërave të zeza në lagjen "Moronicë" dhe në lagjen "Krasniqi" |
| | Ndërtimi i kanalit të ujitjes | Ndërtimi i kanaleve të ujitjes |
| Kaçanik | Ndryshimi i projektit për ndërtimin e kioskave. | Ndërtimi i kioskave për biznese në shesh. |
| Obiliq | Hapja e rrugës, trajtimi me zhavor dhe kanalizimi në rrugën "Hysen Hajdari" | Asfaltimi i rrugës "Hysen Hajdari" në Breznicë. |
| | Ndërtimi i kanalizimit dhe trotuarit në rrugën "Dita e Flamurit" | Asfaltimi i rrugës "Dita e Flamurit" në Mazgit. |
| Pejë | Rruga Sejnov-Gjorë | Asfaltimi i rrugës Sejnove – Gjorë. |


| | | |
|---------|---|--|
| Klinë | Asfaltimi i rrugës "Bekim Fehmiu". | Ndërtimi i segmenteve të rrugës "Mal Bashota", "Dositej Obradoviq", "Bekim Fehmiu" dhe infrastrukturës nëntokësore në Klinë-Dersnik-Dollc. |
| | Sanimi i gropave në rrugët Zllakuqan, Ranoc dhe Leskoc si dhe investimi në kabllot e përcjellësve të rrymës | Asfaltimi i rrugëve Ranoc – Leskoc. |
| | Ndërtimi i trotuarit në rrugën Budisalc-Rudicë | Ndërtimi i rrugëve dhe urës në Budisalcë-Rudicë. |
| | Rregullimi i shtratit të lumit "Drini i Bardhë" | Rregullimi i shtratit të lumit Drini i Bardhë. |
| | Përmirësimi i rrugës Jelloc-Resnik | Ndërtimi i rrugëve dhe infrastruktures nëntokësore në Jashanicë-Jelloc-Resnik. |
| Ferizaj | Vendosja e ndalesave të autobusëve. | Ndërtimi i vendndaljeve, pritoreve të autobusëve |
| | Asfaltimi i rrugëve që lidhen me fshatin. | Asfaltimi i rrugëve që lidhen me fshatin. |
| | Përfundimi i asfaltimit të rrugicave në fshatin Mirash | Asfaltimi i rrugëve në fshatin Mirash |
| | Mbjellja e drunjëve dekorativë. | Ndërtimi i parqeve të reja, Krijimi i hapësirave të gjelbërta (mbjellja e drunjëve dekorativ) |
| | Pastrimi i lumit nga "Ujëvara" e "Ura e Islamit" deri te "ura e Dudit". | Rregullimi i shëtitores rreth shtratit të lumit nga ura e Dudit deri te ura e Islamit |
| Prizren | Kanalizim dhe trotuar nga fshati Krajk deri në fshatin Bregdrini. | Ndërtimi i rrugëve, kanalizimit dhe ndriçimit publik në Krajk. |
| | Ujë të pijshëm (problem në fshatrat Zym, Bregdrini, Karashëngjergj). | Rehabilitimi dhe mirëmbajtja e sistemit të kanalizimit dhe ujësjellesit në qytetin e Prizrenit dhe fshatra të Prizrenit. |
| | Rrugë lokale, trotuar nga fshati Mazrek deri tek fshati Kojushe, ndriçim publik, pastrimi i rrugëve, ndërtimi i ambulancës. | Rregullimi i ndriçimit publik në Mazrek. |

| | | |
|----------|---|--|
| | Kanalizim ne fshatrat Nashec, Grazhdanik | Ndërtimi i rrugëve dhe kanalizimit në Grazhdanik. |
| | Kanalizimi ne fshatrat Kushnin, Kabash i Hasit | Ndërtimi i infrastrukturës në Kushnin Has, rrugët dhe kanalizimi. |
| | Mirëmbajtje dhe kontrolle tek katër ndërtesat që gjenden përballë gjimnazit Loyola. | Rregullimi i infrastrukturës për ndërtesën e katër – Petrovë. |
| | Rregullimi i infrastrukturës rrugore, kanalizim, ndriçim publik te lagjet e reja në fshatin Vlashnje. | Vendosja e ujëmatësve dhe pusëtës për konsumator në pronë publike-Zhur Dobrushtë ,Vërmicë, Shkozë, Vlashnje, Muradem, Kobajë dhe Nashec. |
| | Rregullimi i kanalizimit në fshatin Dobrushtë | Vendosja e ujëmatësve dhe pusëtës për konsumator në pronë publike-Zhur Dobrushtë ,Vërmicë, Shkozë, Vlashnje, Muradem, Kobajë dhe Nashec. |
| | Rregullimi infrastrukturës rrugore ne fshatrat Zym, Karashëngjergj, Bregdrini | Rregullimi i infrastrukturës në Zym (kanalizimet dhe rrugët). |
| Suharekë | Investime në rrugën "Bllacione". | Ndërtimi i rrugëve lokale në Bllacë |
| | Rruga për Breshanc dhe sanimi i rrugës "Djemt e Lirisë". | Ndërtimi i rrugëve lokale në Breshanc |
| | Ndërtimi i rrugës nga Palushë deri te lumi në Buzhalë | Ndërtimi i rrugëve lokale në Budakovë |
| | Hapja e rrugës fushore që të lidh me fshatin Bukosh | Ndërtimi i rrugëve lokale Bukosh |
| | Rruga e UÇK-së – Dubravë – Savrovë. | Ndërtimi i rrugëve lokale në Dubravë |
| | Ndërtimi i trotuareve ne fshatin Dvoran | Ndërtimi i rrugëve lokale në Dvoran |
| | Rrugët dytësore ne fshatin Kasterrc. | Ndërtimi i rrugëve lokale në Kasterc |
| | Vazhdimi i rrugës "Shaban Kryeziu" | Ndërtimi i rrugëve lokale në Leshan |
| | Rruga "Sadri Shala" dhe "Bafti Shala". | Ndërtimi i rrugëve lokale në Mushtisht |
| | Sanimi i rrugës Tërnje – Njëpërbisht | Ndërtimi i rrugëve lokale në Neperebisht |
| | Rregullimi i rrugëve ne fshatin Peqan. | Ndërtimi i rrugëve lokale në Peqan |
| | Ndriçimi publik. | Instalimi dhe sanimi i ndriçimeve publike në fshatra dhe qytet. |
| | Kanalizimi dhe ujësjellësi ne Suharekë | Ndërtimi dhe rikonstruimi i kanalizimeve në qytet |

| | | |
|----------|--|---|
| | Hapja e shtratit të lumit "Mirushë". | Ndërtimi i shtretërve të lumenjëve dhe rikonstruimi i tyre |
| | Trotuar në lagje. | Ndërtimi i trotuarëve dhe parkingjeve në Suharekë |
| | Ura në rrugën kryesore në fshatin Greikoc të rregullohet dhe të zgjerohet. | Ndërtimi i urave në fshatra dhe komunë |
| | Kanalizimi dhe ujësjellësi ne Suharekë | Ndërtimi i rrjetit të ujësjellësit në fshatra dhe në komunë |
| | Mirëmbajtja e rrugëve, kopshteve dhe lapidarëve. | Ndërtimi i rrugëve lokale në Sallagrazhdë |
| | Hapja dhe rregullimi i rrugës drejt varrezave. | Ndërtimi i rrugëve lokale në Samadraxhë |
| | Rruga e UÇK-së – Dubravë – Savrovë. | Ndërtimi i rrugëve lokale në Savrovë |
| | Ndërtimi i rrugëve. | Ndërtimi i rrugëve lokale në Semetisht |
| | Rruga "Vesël Jupa" të shtrohet me zhavorr. | Ndërtimi i rrugëve lokale në Sopiçë |
| | Rregullimi i rrugëve. | Ndërtimi i rrugëve lokale në Studençan |
| | Vendosja e një steme te "Gurra e Kadisë" | Ndërtimi i memorialit te "Gurra e Kadisë" në Budakovë |
| Podujevë | Rregullimi i lumit Llap | Zgjerimi dhe rregullimi i shtratit të lumit "Llap". |
| | Asfaltimi i rrugës Orllan-Ballaban | Asfaltimi i rrugëve në fshatin Orllan. |
| | Rregullimi i trotuarëve | Asfaltimi i rrugëve në fshatin Lupç. |
| | Rregullimi i rrugës kryesore | Asfaltimi i rrugëve në fshatin Sallabajë. |
| | Ndërtimi i rrugës | Asfaltimi i rrugëve në fshatin Lluga. |
| | Probleme me kanalizimin | Zgjerimi dhe rregullimi i kanalizimit në fshatrat Lluzhan, Lupç dhe Majac (Kolektori). |
| | Shtrimi i rrugës "Brainë" me zhavorr | Riparimi i rrugëve me zhavorr. |
| | Rregullimi i rrugës në lagjen e Kangajve | Riparimi i rrugëve të demtuara në qytet dhe fshatra. |
| | Ndërtimi i trotuarit prej urës së Orllanit e deri te rruga e Pazarit | Ndërtimi i trotuarëve në fshatrat: Kerpimeh, Orllan, Lluzhan, Llapashticë, Balloc, Shajkoc dhe Bradash. |
| | Ndërtimi i shkollës së re | Ndërtimi i objektit të shkollës "Nuhi Gashi" Bragash. |
| | Ndërtimi i fushës së sportit | Ndërtimi i terreneve sportive. |

Burimi: Procesverbalet buxhetore të komunave dhe KAB të miratuar 2025–2027

Figura 12. Popullsia sipas etnisë nëpër komuna



Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës

**Planifikimet buxhetore
të komunave për vitin 2025**



Co-funded by
the European Union



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

**Swiss Agency for Development
and Cooperation SDC**



Sweden
Sverige